**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Kaçanik**
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

*01 Nr. 06-350-4709/17*
*Kaçanik, 28.02.2017*

Mbështetur në nenin 12 dhe 17 lidhur me nenin 40.2 (l) të Ligjit 03?L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 qershor 2008) të nenit 5 paragrafi 1.2 si dhe nenet 10.11, 16 dhe 26 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 të datës 23.08.2013 si dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.24/2015, nenit 6.2 dhe 34. 5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 28 Shkurt 2017, mori këtë:

# VENDIM
# PËR HARTIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT

**1.** Lloji dhe Përkufizimi i Dokumentit të Planifikimit Hapësinor është: **Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Kaçanikut**.

**2.** Qëllimi i hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Kaçanikut:

2.1. Me Hartën Zonale të Komunës do të bëhet harmonizimi i zhvillimit të hapësirës me dokumentet e planifikuara, duke ju përshtatur gjendjes ekzistuese, nevojave dhe mundësive reale të zhvillimit me qëllim të:

2.1.1. Promovimin e objektivave të planeve zhvillimore sektoriale dhe hartat e shfrytëzimit të planifikuar të tokës të përcaktuara në Planin Zhvillimor Komunal.

2..1.2. Promovimin e objektivave të komunitetit, ashtu si janë deklaruara në Planin Zhvillimor Komunal si: krijimi i mundësive të reja për punë, ofrimi i banimit të përballueshëm, etj.

2.1.3. Promovimin e shëndetit dhe sigurisë publike dhe të mirëqenies së përgjithshme.

2.1.4. Sigurimin e llojllojshmërisë së shfrytëzimit dhe densiteteve të përshtatshme me karakterin e komunës që pasqyrojnë nevojat aktuale dhe ato të planifikuara.

2.1.5. Nevoja për të balancuar interesin publik me të drejtat e pronës private dhe shfrytëzimin e arsyeshëm të pronës në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me legjislacionin në fuqi.

**3.** Sigurimin e zhvillimit të planifikuar të bazuar në:

3.1. Modelet e shfrytëzimit të tokës të bazuara të Planit Zhvillimor Komunal;

3.2. Gjendjen ekzistuese, marrë parasysh mjedisin e ndërtuar faktik dhe të drejtat pronësore me qellin që hartimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor të jetë real dhe i zbatueshëm;

3.3. Karakteristikat natyrale të tokës, përfshirë përshtatshmërinë e shfrytëzueshme risë të bazuar në karakteristikat e dheut, topografisë dhe ndjeshmërisë ndaj ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;

3.4. Kapacitetet ekzistuese dhe të planifikuara të shërbimeve dhe ndërtesave publike dhe private;

3.5. Nevoja për të formësuar dhe balancuar zhvillimin urban dhe rural;

3.6. Harmonizimin e kërkesave të interesit publik me të drejtat në pronën private nëpërmjet shfrytëzimit të arsyeshëm të pronës;

3.7. Promovimin e teknikave inovative për zhvillim;

3.8. Sigurimin e kontrollit të ndotjes së ajrit, ujit, tokës, ujerave taksorë dhe ndotjes akustike;

3.9. Sigurimin e masave mbrojtëse ndaj zjarrit, erozionit, rrëshqitjes së dheut, ortekëve, tërmeteve dhe vërshimeve;

3.10. Sigurimin e mbrojtjes së karakterit natyror, historik, kulturor dhe peizazhe të territorit të Komunës Kaçanikut;

3.11. Ruajtjen dhe promovimin e traditës në prodhimtarinë bujqësore, pylltari, peshkim, rekreacionit dhe aktiviteteve në hapësirë të Hapur;

3.12. Promovimin e veprimtarive te organizuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë në zonat rurale në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore kualitative dhe kulturave të ndryshme;

3.13. Sigurimin e mbrojtjes së investimeve të infrastrukturës publike, sociale, teknike dhe zhvillimit të integruar e të arritshme në funksion të transportit urban, nder urban, rural dhe menaxhim të mbeturinave;

3.14. Promovimin e mundësive të barabarta për banim të qëndrueshëm për familjet që nuk janë në gjendje ekonomike ti përballojnë ofertat e tregut të banimit me qëllim të stabilitetit social, shëndetit dhe zhvillimit të mirëqenies njerëzore për të gjithë qytetarët nën administrimin territorial të Komunës;

3.15. Sigurimin e mundësisë së shfrytëzimit të tokës në koordinim me komunat fqinje, qeverinë qendrore dhe agjencitë tjera, veçanërisht në lidhje me resurset dhe shërbimet që shtrihen përtej kufijve të komunës apo që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në atë komunë;

3.16. Sigurimin që shfrytëzimi i tokës të përfshijë udhëzime të planifikimit dhe obligimit të cilat rrjedhin nga dokumentet dhe planet hapësinore për rajon më të gjerë e të cilat afektojnë komunën;

3.17. Sigurimin e përfshirjes së elementeve hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunën në procesin e planifikimit hapësinor;

3.18. Sigurimin e rishikimit efikas të propozimeve për zhvillimin dhe kërkesat për leje ndërtimore për sqarim dhe përshpejtim të procedurës;

3.19. Harta Zonale e Komunës të jetë e bazuar në planin hapësinor të komunës, Hartën Zonale të Kosovës dhe interesat kombëtare të paraqitura si objektiva, plane dhe politika oficiale të Qeverisë

3.20. Harta Zonale e Komunës merre parasysh mundësitë e integrimin e planeve rregulluese Urbane që janë në fuqi;

3.21. Harta Zonale e Komunës hartohet në përputhje me normat teknike të planifikimit hapësinor;

3.22. Harta Zonale e Komunës hartohet në formën e cila e bën më të lehtë përdorimin dhe lehtëson monitorimin dhe rishikimin;

3.23. Harta Zonale e Komunës përmes pjesëmarrjes publike merre parasysh kërkesat e të gjithë qytetarëve dhe nevojat speciale të personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, minoriteteve, fëmijëve, të rinjve dhe aspektet të ndjeshme gjinore.

3.24. Përcaktimit të masave, veprimeve duke u bazuar ne afate kohore dhe projeksione financiare.

3.25. Lehtësimit të arritjes së qëllimeve dhe objektivave të planit zhvillimor komunal.

3.26. Hartimit të elaboratit të hollësishëm për kufijtë e zonave dhe kushteve zhvillimore për secilën zonë.

3.27. Harmonizimi i planifikimit zhvillimor dhe ndryshimet në hapësirë.

3.28. Harmonizimit të planifikimit me ndryshimet në kornizën ligjore, relevante dhe

3.29. Shfrytëzimit racional, human të hapësirës, resurseve në pajtim me ligjet, parimet dhe normat teknike.

**4.** Harta Zonale e Komunës do të hartohet për tërë territorin e Komunës së Kaçanikut.

**5.** Subjekt përgjegjës për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Kaçanikut do të caktohet në bazë të konkursit të projektimit, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, duke asistuar të gjitha palët e interesit përfshirë Kryetarin e Komunës, Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoritë tjera të Komunës, Shoqëritë Civile dhe qytetarët.

6. Mjetet dhe mekanizmat e nevojshme për hartimin e Hartës Zonale do të sigurohen nga Buxheti i Komunës së Kaçanikut.

**7.** Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

8. Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe organet tjera relevante.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit ( përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante);
3. Drejtoria për Ekonomi dhe Financa; dhe
4. Arkivi.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT REPUBLIKA KOSOVA OPŠTINA KAČANIK

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

**Drejtoria e Urbanzimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**
06.Nr.350-4709 /17
Kaçanik, 13.02.2017

## LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **REFERENCË:** | | | | | |
| **PËR/ZA/TO:** | **Kuvendin Komunal** | | | | |
| **CC:** | | | | | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | | | | | |
| **NGA/OD/FROM:** | **Ukshin Çallaku, drejtor i DUKMM** | | | | |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Hartimi i hartës zonale të Komunës së Kaçanikut** | | | | |
| **Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:** | | **Lokacioni: Kucni: Extension:** | **Administrata Komunale** | **Data: Datum: Date:** | **13.02.2017** |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | | | | | X ☐ |
| PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL | | | | | ☐ |
| PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION | | | | | ☐ |
| **AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE** | | | | | |

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L174, Udhëzimit Administrativ Nr.24/2015, nenit 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, propozojmë marrjen e vendimit për fillimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Kaçanikut, bashkangjitur e gjeni programin e shkëputur të hartimit të këtij dokumenti.

1.Lloji dhe përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinorë

- **Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Kaçanikutt**

2.Qëllimi i hartimit të hartës zonale të Komunës së Kaçanikut

Me Hartën Zonale të Komunës do të bëhet harmonizimi i zhvillimit të hapësirës me dokumentet e planifikuara, duke ju përshtatur gjendjes ekzistuese, nevojave dhe mundësive reale të zhvillimit me qëllim të:

- Promovimin e objektivave të planeve zhvillimore sektoriale dhe hartat e shfrytëzimit të planifikuar të tokës të përcaktuara në Planin Zhvillimor Komunal.

• Promovimin e objektivave të komunitetit, ashtu si janë deklaruara në Planin Zhvillimor Komunal si: krijimi i mundësive të reja për punë, ofrimi i banimit të përballueshëm, etj.

• Promovimin e shëndetit dhe sigurisë publike dhe të mirëqenies së përgjithshme.

• Sigurimin e llojllojshmërisë së shfrytëzimit dhe densiteteve të përshtatshme me karakterin e komunës që pasqyrojnë nevojat aktuale dhe ato të planifikuara.

• Nevoja për të balancuar interesin publik me të drejtat e pronës private dhe shfrytëzimin e arsyeshëm të pronës në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me legjislacionin në fuqi.

3. Sigurimin e zhvillimit të planifikuar të bazuar në:

• Modelet e shfrytëzimit të tokës të bazuara të Planit Zhvillimor Komunal

• Gjendjen ekzistuese, marrë parasysh mjedisin e ndërtuar faktik dhe të drejtat pronësore me qellin që hartimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor të jetë real dhe i zbatueshëm

• Karakteristikat natyrale të tokës, përfshirë përshtatshmërinë e shfrytëzueshmerisë të bazuar në karakteristikat e dheut, topografisë dhe ndjeshmërisë ndaj ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;

• Kapacitetet ekzistuese dhe të planifikuara të shërbimeve dhe ndërtesave publike dhe private;

• Nevoja për të formësuar dhe balancuar zhvillimin urban dhe rural;

• Harmonizimin e kërkesave të interesit publik me të drejtat në pronën private nëpërmjet shfrytëzimit të arsyeshëm të pronës;

• Promovimin e teknikave inovative për zhvillim;

• Sigurimin e kontrollit të ndotjes së ajrit, ujit, tokës, ujerave taksorë dhe ndotjes akustike;

• Sigurimin e masave mbrojtëse ndaj zjarrit, erozionit, rrëshqitjes së dheut, ortekëve, tërmeteve dhe vërshimeve;

• Sigurimin e mbrojtjes së karakterit natyror, historik, kulturor dhe peisazhor të territorit të Komunës Kaçanikut;

• Ruajtjen dhe promovimin e traditës në prodhimtarinë bujqësore, pylltari, peshkim, rekreacionit dhe aktiviteteve në hapësirë të Hapur;

• Promovimin e veprimtarive te organizuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë në zonat rurale në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore kualitative dhe kulturave të ndryshme;

• Sigurimin e mbrojtjes së investimeve të infrastrukturës publike, sociale, teknike dhe zhvillimit të integruar e të arritshme në funksion të transportit urban, nder urban, rural dhe menaxhim të mbeturinave;

• Promovimin e mundësive të barabarta për banim të qëndrueshëm për familjet që nuk janë në gjendje ekonomike ti përballojnë ofertat e tregut të banimit me qëllim të stabilitetit social, shëndetit dhe zhvillimit të mirëqenies njerëzore për të gjithë qytetarët nën administrimin territorial të Komunës;

• Sigurimin e mundësisë së shfrytëzimit të tokës në koordinim me komunat fqinje, qeverinë qendrore dhe agjencitë tjera, veçanërisht në lidhje me resurset dhe shërbimet që shtrihen përtej kufijve të komunës apo që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në atë komunë;

• Sigurimin që shfrytëzimi i tokës të përfshijë udhëzime të planifikimit dhe obligimit të cilat rrjedhin nga dokumentet dhe planet hapësinore për rajon më të gjerë e të cilat afektojnë komunën;

• Sigurimin e përfshirjes së elementeve hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunën në procesin e planifikimit hapësinor;

• Sigurimin e rishikimit efikas të propozimeve për zhvillimin dhe kërkesat për leje ndërtimore për sqarim dhe përshpejtim të procedurës;

• Harta Zonale e Komunës të jetë e bazuar në planin hapësinor të komunës, Hartën Zonale të Kosovës dhe interesat kombëtare të paraqitura si objektiva, plane dhe politika oficiale të Qeverisë

• Harta Zonale e Komunës merre parasysh mundësitë e integrimin e planeve rregulluese Urbane që janë në fuqi;

• Harta Zonale e Komunës hartohet në përputhje me normat teknike të planifikimit hapësinor;

• Harta Zonale e Komunës hartohet në formën e cila e bën më të lehtë përdorimin dhe lehtëson monitorimin dhe rishikimin;

• Harta Zonale e Komunës përmes pjesëmarrjes publike merre parasysh kërkesat e të gjithë qytetarëve dhe nevojat speciale të personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, minoriteteve, fëmijëve, të rinjve dhe aspektet të ndjeshme gjinore.

• Përcaktimit të masave, veprimeve duke u bazuar ne afate kohore dhe projeksione financiare.

• Lehtësimit të arritjes së qëllimeve dhe objektivave të planit zhvillimor komunal.

• Hartimit të elaboratit të hollësishëm për kufijtë e zonave dhe kushteve zhvillimore për secilën zonë.

• Harmonizimi i planifikimit zhvillimor dhe ndryshimet në hapësirë.

• Harmonizimit të planifikimit me ndryshimet në kornizën ligjore, relevante dhe

• Shfrytëzimit racional, human të hapësirës, resurseve në pajtim me ligjet, parimet dhe normat teknike.

4. Harta Zonale e Komunës do të hartohet për tërë territorin e Komunës së Kaçanikut.

5. Subjekt përgjegjës për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Kaçanikut do të caktohet në bazë të konkursit të projektimit, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, duke asistuar të gjitha palët e interesit përfshirë Kryetarin e Komunës, Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoritë tjera të Komunës, Shoqëritë Civile dhe qytetarët.

6. Mjetet dhe mekanizmat e nevojshme për hartimin e Hartës Zonale do të sigurohen nga Buxheti i Komunës së Kaçanikut.